

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

- I. Seminari i të premtës
- II. Punët kërkimore të sapopërfunduara
- III. Artikuj dhe materiale diskutimi në proces
- IV. Artikuj, intervista, fjalë të drejtuesve e punonjësve të Bankës, të botuara në shtypin e përditshëm
- V. Të ndryshme

I. SEMINARI I TË PREMTËS

“Seminari i të Premtës” për gjashtëmuorin e dytë të 2009-ës nisi me prezantimin e Didar Erdinç, Profesore e Ekonomisë në Universitetin Amerikan në Bullgari, me temë: “A rrit kreditimi i lartë brishtësinë e sistemit bankar? Sfida të tranzicionit në sistemin bankar të Bullgarisë në vitet 1997- 2007”. Ky material studimi identifikon përcaktuesit e rritjes së shpejtë të kredisë në Bullgari dhe vlerëson nëse kreditimi i lartë ka rritur brishtësinë e sistemit bankar. Analiza bazohet në të dhëna në formë paneli për 30 banka në Bullgari gjatë periudhës 1999-2006. Duke përdorur metodat Fixed Effects dhe GMM për të vlerësuar lidhjen midis kredisë dhe kapitalit të bankave, studimi konkludon se ka një rrezik në rritje të zgjerimit të kreditimit dhe vlerëson ndikimin e tij mbi sistemin bankar në Bullgari. Rezultatet e studimit sugjerojnë se kreditimi i lartë në Bullgari ka ndodhur në kurriz të rritjes së brishtësisë së sistemit bankar, duke rritur probabilitetin e falimentimit të bankave në rast të një reduktimi të likuiditetit financiar në rang botëror, realitet i cili u bë mjaft shqetësues në vitin 2008.

Në tremujorin e fundit të 2009-ës, Lorina Green dhe Rezart Erindi, nga Departamenti i Operacioneve Monetare, prezantuan: “Përdorimi i modelit KMV-Merton për të parashikuar mundësinë e dështimit të firmave në shlyerjen e borxhit të emetuar”. Për shkak të shtimit të produkteve të borxhit të emetuar nga firmat dhe të përdorimit gjithnjë e më të madh të derivateve të kreditit ka pasur një interes në rritje për modele që parashikojnë mundësinë e dështimit të firmave në shlyerjen e borxhit të tyre. Një model që sjell risi në parashikime, i aplikuar gjerësisht si në praktikë ashtu dhe në kërkimet akademike, është një zbatim i veçantë i modelit të Merton-it (1974) zhvilluar nga korporata KMV. Ky material ka si qëllim prezantimin e këtij modeli, dhe parashtron mundësinë për vënien në përdorim të tij brenda Bankës së Shqipërisë.

Prezantimi tjetër i mbajtur në këtë seminar është ai me temë: “Përzgjedhja e benchmark-ut strategjik. Aspekte teorike dhe praktike”, nga Rezart Erindi

dhe Valbona Luga, Departamenti i Operacioneve Monetare. Përzgjedhja e benchmark-ut strategjik mund të përshkruhet si procesi nëpërmjet të cilit një institucion vendos për mënyrën e shpërndarjes neutrale të investimit (instrumenteve financiare) në çdo moment të kohës, për të arritur objektivat afatgjata të investimit. Ky proces mund të përshkruhet nga hapat e mëposhtëm:

1. formulimi i objektivave dhe përcaktimi i detyrimeve të institucionit;
2. përcaktimi i kthimit, tolerancës ndaj rrezikut dhe horizontit kohor;
3. identifikimi i klasave të instrumenteve në të cilat mund të investohet dhe përcaktimi i pritjeve për tregun;
4. marrja e vendimit për përzgjedhjen e benchmark-ut strategjik;
5. vënia në zbatim e benchmark-ut strategjik dhe vlerësimi i përzgjedhjes.

Në këtë material, autorët përqendrohen në hapat e fundit të procesit duke përshkruar metodologjinë që ndiqet për ndërtimin e propozimeve për benchmark-ut strategjik dhe vlerësimin në kohë të kësaj metodologjie. Gjithashtu, ata përcaktojnë dhe klasat e instrumenteve të lejuara për investim.

Në muajin nëntor, Armela Mançellari, nga Departamenti i Kërkimeve, prezantoi: "Vlerësimi afatshkurtër i PBB-së reale". Qëllimi i këtij materiali është ndërtimi i modeleve për parashikimin afatshkurtër për tremujorin aktual të vlerës së PBB-së së vendit. Për vendimmarrje të mirinformuar nevojitet vlerësimi i situatës aktuale ekonomike me disa mënyra dhe prospektet afatshkurtra mbi ecurinë e ekonomisë reale. Duke qenë se të dhënat mbi PBB-në

tremujore në Shqipëri publikohen me 12 javë vonesë, lind nevoja për parashikimin e ecurisë së këtij treguesi para se ai të publikohet. Ky material përdor të dhëna nga shitjet reale, shitja dhe riparimi i automjeteve dhe nga komponentët e indekseve të besimit për të parashikuar PBB-në e tremujorit aktual duke përdorur modele ekonometrike.

Materiali i parë i diskutuar për muajin dhjetor ishte: "A ekziston multiplikatori fiskal? Reagimet fiskale dhe monetare, besueshmëria dhe multiplikatorët fiskalë në Hungari?" nga Zoltan Jakab, Drejtor i Analizës Makroekonomike, Zyra e Këshillimit Fiskal, Republika e Hungarisë. Materiali ka për qëllim vlerësimin e multiplikatorëve të politikës fiskale në Hungari nëpërmjet përdorimit të modelit DSGE. Rezultatet tregojnë se multiplikatorët e treguesve të ndryshëm të politikës fiskale ndryshojnë nga njëri-tjetri. Perceptimi i agjentëve të ekonomisë mbi vazhdueshmërinë e stimulit fiskal ka një ndikim të rëndësishëm mbi multiplikatorët. Gjithashtu, multiplikatorët ndryshojnë kur merren parasysh mënyrat se si do të financohet politika fiskale ekspansioniste në të ardhmen. Gjetjet sugjerojnë se në një ekonomi të vogël dhe të hapur ku politika monetare reagon më së shumti ndaj inflacionit, akomodimi që ajo i bën politikës fiskale nuk ndikon mbi multiplikatorët fiskalë.

Prezantimi i fundit i tremujorit ishte: "Modelimi i PBB-së tremujore - roli i treguesve ekonomikë dhe atyre të vrojtimit" nga Evelina Çeliku, Ermelinda Kristo dhe Merita Boka, Departamenti i Politikës Monetare. Qëllimi i materialit është vlerësimi në terma afatshkurtëri prires së PBB-së tremujore në rastin e Shqipërisë nëpërmjet tri përqasjeve kryesore: a.

Modele ARIMA me përbërës sezonalë; b. Modele indikatorë – urëlidhës (Bridge Models), dhe c. Modele VAR. Përdorimi i këtyre modeleve ka mundësuar përfitimin e vlerësimeve paraprake mbi dinamikën e aktivitetit ekonomik rreth prirjes kryesore për tremujorin referues (nowcast) dhe për deri në dy tremujorë në vijim (parashikim). Materiali arrin në përfundimin se variablat nga vërtetimet përmbajnë informacion të

vlefshëm për parashikimet afatshkurtra të PBB-së tremujore. Gjithashtu, parashikimi “më i mirë”, merret nga mesatarja e parashikimeve nga modelet e ndryshme (pa përfshirë modelet ARIMA). Së fundi, performanca e parashikimit jashtë periudhës do të jetë ajo që do të luajë rol ponderues në përzgjedhjen e modeleve më të përshtatshme në llogaritjen e parashikimit mesatar.

II. PUNËT KËRKIMORE TË SAPOPËRFUNDUARA

1. 1. “NJË KËNDVËSHTRIM TJETËR MBI LIDHJEN E KËRKESËS PËR PARA DHE PRIMIT TË TREGJEVE INFORMALE” - NGA ALTINTANKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Qëllimi i këtij studimi është matja e besueshmërisë së politikave ekonomike, duke u fokusuar në zhvillimet në kërkesën për para dhe luhatshmërinë në tregjet informale të valutës, reflektuar në primin e tregut të zi.

Besueshmëria është një parakusht i nevojshëm për suksesin e çdo politike apo reforme ekonomike. Ajo ka qenë një shqetësim për vendet më pak të zhvilluara, për vendet në zhvillim, si dhe për ato të zhvilluara. Në çdo kohë, agjentët ekonomikë perceptojnë se autoritetet i japin prioritet objektivave të tyre afatshkurtra përkundëjt qëndrueshmërisë afatgjatë makroekonomike. Gjithashtu, këta agjentë nuk kanë besim tek objektivat e politikave të shpallura dhe për këtë arsye nuk i modelojnë pritshmëritë e

tyre bazuar mbi to. Ky material studion kërkesën afatgjatë për para nën supozimin që kursi i këmbimit shërben si matës i kostos së mbajtjes së parasë. Duke përdorur vlerësimin ARDL (Autoregressive Distributed Lag) dhe përjasjen bound testing për kointegrim mbi të dhënat me frekuencë tremujore nga 8 vende në zhvillim, materiali studion sjelljen e kërkesës për para në kushtet e luhatjeve afatshkurtra të primit në tregun e zi të kursit të këmbimit. Në këtë këndvështrim, materiali propozon një metodë të re për të testuar kredibilitetin e politikave ekonomike që implementohen në vendet e marra në studim. Testi konsiston në përfshirjen në vlerësim të primit të tregut të zi në vend të kursit të këmbimit, të funksioni i parasë dhe vlerësimi i këtij të fundit në formën Error Correction.

Rezultatet e marra tregojnë se kjo lidhje ka potencial për të siguruar të dhëna mbi besueshmërinë e politikave ekonomike dhe mbi mënyrën se si perceptohet nga agjentët ekonomikë.

2. “NJË PËRQASJE STOCK-FLOW NDAJ KURSIT EKUILIBËR TË KËMBIMIT LEK/EURO” - NGA ILIR VIKA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE ERJON LUÇI (BANKA BOTËRORE, SHQIPËRI)

Studimi ka për qëllim të identifikojë faktorët përcaktues në zhvillimet e kursit të këmbimit, të vlerësojë një kurs ekuilibër dhe të vlerësojë nëse kursi aktual i këmbimit është i zhvendosur ndaj atij ekuilibër. Përcaktuesit e kursit ekuilibër të konsideruar në këtë studim përfshijnë diferencën e produktivitetit, mjetet e huaja neto, shpenzimet e qeverisë, diferencën e normave të interesit, shkallën e hapjes së ekonomisë, remitancat dhe kushtet e tregtisë. Metodologjia e përdorur është ARDL (Autoregressive Distributed Lag), zhvilluar nga Pesaran dhe Shin (1999). Autorët konkludojnë se kursi real i këmbimit nuk duket të jetë shmangur në mënyrë të konsiderueshme nga ekuilibri afatmesëm.

3. “PERSISTENCA E INFLACIONIT NË SHQIPËRI” - NGA VASILIKA KOTA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky studim paraqet një vlerësim të persistencës së inflacionit gjatë viteve 1993-2008. Sipas autores, inflacioni në Shqipëri është persistent, ka një shmangie të konsiderueshme në mesataren e inflacionit gjatë dy periudhave me regjim monetar të ndryshëm, dhe inflacioni bazë shfaq persistencë më të lartë se ai total. Një ndër konkluzionet kryesore të studimit është se politika monetare e bankës

qendrore ka qenë efektive në reduktimin e inflacionit.

4. “ANALIZA E SISTEMIT BANKAR SHQIPTARNËN KËNDVËSHTRIMIN RREZIK-PERFORMANCË” - NGA IRINI KALLUCI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Industria bankare përbën elementin më të rëndësishëm të sistemit financiar shqiptar dhe për rrjedhojë kërkon një vëmendje më të madhe kur bëhet fjalë për analizat financiare të saj. Ky material trajton teorikisht dhe analitikisht, tregues të rrezikut dhe kthimit, si dhe për herë të parë, paraqet metodologjinë e përlllogaritjes së një indeksi rreziku për sistemin bankar shqiptar, bazuar në modelin e sugjeruar nga Hannan dhe Hanweck (1988). Studimi në fjalë, zbërthen treguesin ROE nëpërmjet modelit të modifikuar DuPont dhe identifikon faktorët që ndikojnë më shumë në këtë tregues. Gjithashtu, ndërtohet një matricë prej 28 raportesh të vlefshme për analizat financiare të sistemit bankar, duke u nisur nga disa tregues sasiore. Ky punim synon jo thjesht të analizojë disa raporte financiare të rrezikut dhe performancës, por mbi të gjitha të sugjerojë disa tregues të rinj dhe një indeks që mund të përdoret nga mbikëqyrësit gjatë punës së tyre. Aktualisht, analiza e raporteve financiare sipas metodologjisë të sugjeruar në këtë studim dhe mënyra e llogaritjes së indeksit të rrezikut, janë vendosur në përdorim duke u aplikuar nga Departamenti i Stabilitetit Financiar në raportet dhe analizat e tyre periodike.

5. "ZHVILLIMI FINANCIAR DHE RITJJA EKONOMIKE: RASTI I SHQIPËRISË" - NGA ELONA DUSHKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material hulumton lidhjen shkak-pasojë midis zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike për rastin e Shqipërisë, duke përdorur testin e Granger-Causality për pesë tregues të ndryshëm të zhvillimit financiar. Gjetjet empirike të këtij materiali tregojnë, që në afatin e gjatë vërtetohet lidhja pozitive midis të gjithë treguesve që matin zhvillimin financiar dhe rritjen ekonomike. Ndërsa, në afatin e shkurtër kjo lidhje nuk është mjaft e qartë, pasi tregues të ndryshëm japin rezultate të ndryshme. Të dhënat e marra në studim i përkasin periudhës 1996-2007.

6. "STRESS-TESTI I RISKUT INDIREKT TË KREDITIT NË SHQIPËRI" - NGA HILDA SHIJAKU (DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR) DHE KLITI CECA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)

Metodologjia e matjes së riskut indirekt të kreditit është mbështetur në rastin e propozuar nga Wong et al. (2006), i cili transformon një ekuacion të vetëm në një sistem ekuacionesh.

Autorët konkludojnë se ndryshimet në kursin e këmbimit të euros dhe të Euriborit kanë një efekt të konsiderueshëm mbi raportin e kredive me probleme, ndërkohë që edhe efekti i rritjes së PBB-së rezultojnë të jetë i pranishëm, ndonëse i vogël.

III. ARTIKUJ DHE MATERIALE DISKUTIMI NË PROCES

Në këtë periudhë, puna kërkimore në Bankën e Shqipërisë është fokusuar në temat e mëposhtme:

1. "MAKROMODELI GAP PËR SHQIPËRINË" – DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Departamenti i Kërkimeve po punon për ndërtimin e një modeli të vogël makroekonomik i cili do të ketë vetëm katër ekuacione të vlerësuar. Modeli tenton të përcaktojë projeksione në lidhje me PBB-në, inflacionin, normën e interesit dhe të kursit të këmbimit, të gjitha në terma të devijimit të tyre nga nivelet ekuilibër. Për këtë arsye, ky model njihet si modeli

GAP (hendek). Ky model ka avantazhin e të qenurit mjaft i thjeshtë dhe transparent dhe gjithashtu merr në konsideratë variablat kyç të ekonomisë për analizimin e politikës monetare. Modeli është një ndërthurje e karakteristikave të Teorisë Kejnsoniane të Re (roli i kërkesës agregate në përcaktimin e prodhimit) dhe modeleve DSGE me pritshmëri racionale. Modeli është strukturor sepse ekuacionet kanë një interpretim ekonomik dhe përfshin një ekuilibër të përgjithshëm të ekonomisë sepse variablat endogjenë ndërvaren nga njëri tjetri. Aktualisht, puna është përqendruar në vlerësimin e ekuacioneve dhe përcaktimin e vlerave potenciale për secilin prej variablave makroekonomikë.

2. "NIVELI I REZERVËS OPTIMALE: RASTI I SHQIPËRISË" - NGA GERTI SHIJAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Qëllimi i këtij materiali është të prezantojë një model empirik lidhur me nivelin optimal të rezervave ndërkombëtare për një ekonomi të vogël, të hapur si Shqipëria, duke marrë parasysh goditjet e ndryshme ekzgjene që mund të pësojë ambienti makroekonomik.

3. "A KA NEVOJË POLITIKA FISKALE NË SHQIPËRI PËR NJË RREGULL FISKAL – EVIDENCA NGA EFEKTI CROWDING OUT DHE DEFICITET BINJAKE" - NGA ARMELA MANÇELLARI DHE GERTI SHIJAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Qëllimi i këtij materiali është të vlerësojë efektin e politikës fiskale në Shqipëri dhe indikatorë të ndryshëm ekonomikë me synim evidentimin e një rregulli fiskal. Fokusi kryesor i kushtohet efektit të zëvendësimit (crowding out) mbi konsumin dhe investimet private dhe deficitit binjak (twin deficit) me llogarinë tregtare.

4. "ZHVILLIMI FINANCIAR DHE INFLACIONI NË SHQIPËRI" - NGA VASILIKA KOTA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Materiali vlerëson lidhjen midis inflacionit dhe zhvillimit financiar në Shqipëri. Përgjithësisht, studimet kanë treguar se kjo lidhje nuk është lineare. Normalisht rritja e inflacionit ka një

ndikim të ulët pozitiv kur normat fillestare të inflacionit janë të ulëta dhe negativ nëse ato janë të larta. Ky material synon të testojë nëse kjo hipotezë qëndron për rastin e Shqipërisë, duke studiuar lidhjen midis inflacionit dhe depërtimit financiar me anë të kontrollit mbi tregues të tillë si PBB-ja për frymë, hapja e vendit ndaj tregtisë dhe pjesa e konsumit publik ndaj PBB-së.

5. "NJË STUDIM PËR PROBABILITETIN E FALIMENTIMIT TË SISTEMIT BANKAR" - NGA IRINI KALLUCI DHE ORIELA KODRA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky studim synon të ofrojë dhe zbatojë një metodologji për matjen e probabilitetit të falimentimit, si një nga elementet përbërëse të rrezikut të kredisë - për rastin e bankave që operojnë në Shqipëri. Matja e këtij probabiliteti merr rëndësi, pasi Shtylla e Parë e Bazël II, i kushton një vëmendje të veçantë rreziqeve kryesore që ndeshin bankat dhe sidomos rrezikut të kredisë.

6. "VLERËSIMI I EFEKTIT AFATGJATË TË TURIZMIT NË RITJEN EKONOMIKE TË SHQIPËRISË" - NGA JONEL KRISTO, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky studim synon të masë efektin e sektorit të turizmit në rritjen e përgjithshme ekonomike të vendit tonë gjatë periudhës 1995-2008. Duke analizuar fluksin e vizitorëve të huaj dhe të ardhurat totale reale në ekonomi, është analizuar lidhja afatgjatë e turizmit me rritjen ekonomike.

7. "STRESS-TESTING MBI RISKUN INDIRECT TË KREDITIT NË SHQIPËRI , BAZUAR NË KARAKTERISTIKAT E BANKËS" - NGA KLITI CECA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE HILDA SHIJAKU (DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR)

Materiali studion reagimin e raportit të kredive me probleme ndaj kushteve

makroekonomike që përkeqësojnë aftësinë paguese të huamarrësve. Ky ndikim shihet nëpërmjet kanaleve të rrezikut të kredisë sipas karakteristikave të bankave si madhësia, pronësia, kapitalizimi dhe tipare të tjera të portofolit të kredisë. Empirikisht, modeli është mundësuar me vlerësimin e të dhënave panel të bankave në Shqipëri dhe do të jetë me vlerë të shtuar në vlerësimin e parametrave që përdoren për stress-testing e bankave individuale.

V. TË NDRYSHME

TAKIMI I TRETË RAJONAL: "KËRKIMET EKONOMIKE NË EVROPËN JUGLINDORE"

Në datat 19-21, nëntor Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën e Greqisë organizoi takimin e 3të të diskutimit "Kërkimet Ekonomike në Evropën Juglindore", në Bankën e Greqisë, Athinë. Në të morën pjesë 13 përfaqësues (prezantues dhe diskutantë) nga Banka e Shqipërisë dhe rreth 30 përfaqësues nga banka qendrore të rajonit, Banca d'Italia, Osterreichische National Bank, Komisioni Evropian, Eurobank EFG Group, National Bank of Greece etj.

Qëllimi i workshop-it, tashmë i konsoliduar, është përmirësimi i mëtejshëm i kërkimit ekonomik në rajon dhe zgjerimi i njohurive të bankave qendrore të rajonit mbi karakteristikat dhe zhvillimet ekonomike specifike të vendeve tona. Workshop-i i 3të i Kërkimeve zgjati 2 ditë, i ndarë në 6 sesione. Fushat kryesore të trajtuara ishin: stabiliteti

financiar e ekonomik; bankingu dhe financa; dhe zbalancimet e brendshme dhe të jashtme.

Dita e parë u hap nga Zëvendësguvernatorja e Bankës së Greqisë, Eleni Dendrinou-Louri, e cila i dha fjalën Gikas Hardouvelis, kryeekonomist në Eurobank EFG Group, i cili referoi temën "Evropa Juglindore pas krizës: Sfida e Perspektiva", duke hapur kështu sesionin "Karakteristika makroekonomike në Evropën Juglindore". Më pas, ky sesion vijoi me prezantimin e Altin Tankut "Një këndvështrim tjetër mbi lidhjen e kërkesës për para dhe primit të tregjeve informale". (Shih Punët kërkimore të sapopërfunduara). Prezantimi i dytë ishte ai i Vasilika Kotës me temë "Persistenca e inflacionit në Shqipëri". Ky studim paraqet një vlerësim të persistencës së inflacionit gjatë viteve 1993-2008. (Shih Punët kërkimore të sapopërfunduara)

Sesioni i dytë "Bankingu qendror në Evropën Juglindore: Çështje të matjeve

dhe politikave” nisi me fjalën hyrëse të Carlos Martinez Mongay – përgjegjës sektori pranë Komisionit Evropian, i cili diskutoi mbi “Parashikimet Ekonomike të Komisionit Evropian: Metodologjia e përdorur dhe Outlook-u aktual”. Më pas, Oriela Kodra prezantoi punimin “Vlerësimi i peshave për Indeksin e Kushteve Monetare në Shqipëri”. Qëllimi i studimit është përcaktimi i peshës relative të normës së interesit ndaj kursit të këmbimit në llogaritjen e indeksit të kushteve monetare në Shqipëri, me anë të vlerësimit OLS. Përfaqësuesi i Bankës Kombëtare të Bullgarisë prezantoi “Modeli i një ekonomie të vogël të hapur: Rasti i Bullgarisë”, ku diskutante ishte Armela Maçellari. Temë të veçantë dhe mjaft interesante pati Arta Pisha me “Indekset e Eurozonës: Një model i ri për matjen e pavarësisë së Bankës Qendrore në Zonën Euro”. Autorja propozon një mënyrë të re të matjes së pavarësisë së bankave qendrore në Zonën Euro. Indeksi i propozuar sugjeron se Shqipëria duhet të përmirësojë legjislacionin e saj në drejtim të pavarësisë buxhetore e financiare dhe pavarësisë së personelit.

Dita e dytë nisi me sesionin “Stabiliteti financiar dhe risku sovran”, ku prezantuesi i parë ishte Georgios Moschovis – Komisioni Evropian – me temën “Konsolidimi fiskal në vendet candidate dhe candidate potenciale: roli i objektivit për integrim evropian”. Altin Tanku diskutoi këtë prezantim. Në vijim, Sophia Lazaretou (Banka e Greqisë, njëkohësisht bashkëkoordinatore e Workshop-it), Mirna Dumičić (Banka Kombëtare e Kroacisë), dhe George Stubos (Banka e Greqisë) prezantuan temat respektive mbi ekspozimin e sistemit bankar grek në Evropën Juglindore; përcaktuesit e primit

të riskut të borxhit sovran në ekonomitë evropiane në zhvillim etj.

Sesioni i katërt i workshop-it “Risku dhe teknikat e reduktimit të tij në sistemet lokale bankare” u hap me prezantimin e Thomas Scheiber “Gjetjet me anë të anketave të nivelit të eurorizimit në ekonomitë e Evropës juglindore”. Më pas, Arjan Kadareja – anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë – prezantoi punimin “Informacioni i vjetëruar, goditjet dhe luhatshmëria”, shkruar në bashkëpunim me Reint Gropp – European Business School dhe ZEW. Autorët propozojnë një përjasje të re në matjen e efektit të informacionit privat të pavëzhgueshëm në luhatshmërinë e të ardhurave nga aksionet. Të dhënat mbështesin hipotezën e tyre se me vjetërimin e informacionit publik të disponueshëm, efektet e luhatshmërisë dhe persistenca e saj rriten, duke qenë se informacioni privat i investitorëve bëhet më i rëndësishëm për vendimmarrje. Një ndër implikimet kryesore të këtij rezultati është se transparenca e bankave, niveli i detajimit të llogarive jashtë bilancit, dhe frekuenca e publikimit të informacionit vlerësohen nga investitorët. Pas tij, përfaqësuesi i Bankës së Turqisë, Musa Orak, vijoi me prezantimin e temës “Matja e pritshmërive të tregut mbi vendimin e politikës monetare”, diskutuar nga Arjan Kadareja. Tema e fundit e këtij sesioni ishte “Stress-testi i riskut indirekt të kreditit në Shqipëri” e Hilda Shijaku dhe Kliti Ceca. (Shih Punët kërkimore të sapopërfunduara).

Sesioni i pestë u hap me prezantimin e Irlini Kallucit “Analiza e sistemit bankar shqiptar nën këndvështrimin e risk-performancë”. (Shih Punët kërkimore të

sapopërfunduara). Ky punim u diskutua nga Rajna Hoxholli dhe Sofika Note. Workshop-i vijoi me prezantimin e Rilind Kabashit dhe Mihajlo Vaskov – Banka e Republikës së Maqedonisë – mbi përcaktuesit e normave të kredisë në Maqedoni. Elsa Kristo, përfaqësuese e Raifeissen Bank Albania, prezantoi temën “Ndërgjegjësimi për rrezikun e mashtrimit bankar”, e cila u diskutua nga Elvida Orhan. Diskutimet mbi risqet ndaj sistemit bankar vazhduan me përfaqësuesen e Bankës së Rusisë, Tatiana Malakhova, e cila mbylli dhe sesionin e pestë.

Sesioni i fundit, i drejtuar nga Altin Tanku, kishte si synim diskutimin mbi integrimin e rajonit në mjedisin financiar global. Në këtë kuadër, Ilir Vika prezantoi temën “Një përfaqëse stock-flow ndaj kursit ekuilibër të këmbimit Lek/Euro”, studim në bashkëpunim me Erjon Luçin (Banka Botërore, Shqipëri). (Shih Punët kërkimore të sapopërfunduara).

Sesioni vijoi me prezantimet e Dimitros Dapontas (Universiteti i Peloponezit) dhe Dimitros Sideris (Banka e Greqisë) përkatësisht mbi “Krizat valutore: rasti i Hungarisë” dhe “Ecuria e vendeve të Ballkanit në procesin e integritimit evropian”.

Ky workshop pati pjesëmarrje mjaft të gjerë, gjë që flet për interesin në rritje

për kërkimin dhe diskutimet ekonomike në rajon dhe për rajonin. Bashkëpunimi rezultoi mjaft i frytshëm dhe i suksesshëm. Në të ardhmen pritet të ketë bashkëpunime me banka të tjera qendrore të rajonit. Siç shprehet dhe në qëllimin e tij, Workshop-i i Kërkimeve Ekonomike në Evropën Juglindore po kontribuon mjaft në rritjen e shkallës së integritimit dhe të nivelit të kërkimit e bashkëpunimit mes bankave tona të rajonit dhe më gjerë.

DITARI I KRIZËS

Në fillim të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2009, përfundoi përgatitja e rubrikës “Ditari i Krizës”, punuar nga Irini Kalluci, Armela Mançellari dhe Gerti Shijaku, specialistë në Departamentin e Kërkimeve. Ditari i Krizës paraqet informacion të detajuar me një renditje kronologjike sipas datës së ndodhjes, mbi ndryshimet rregullative të ndodhura dhe masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë gjatë viteve 2007, 2008 dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009. Gjithashtu, “Ditari i Krizës” përfshin edhe masat e marra gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2009, nga institucione të huaja, ku kryesisht përfshihen Banka Qendrore Evropiane, Rezerva Federale (FED), banka të tjera qendrore, qeveri të vendeve të tjera si dhe nga bankat mëma apo aksionerët e bankave që operojnë në Shqipëri.

LINQE:**PUNË KËRKIMORE TË BANKAVE TË TJERA QENDRORE**

European Central Bank (<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>)

Bank of Greece (<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>)

Deutsche Bundesbank (http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php)

Oesterreichische Nationalbank (http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp)

Banca d'Italia (<http://www.bancaditalia.it/studicerche>)

Czech National Bank (<http://www.cnb.cz/en/research/>)

Banco de Espana (<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>)

Bank of Finland (http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm)

Bank of England (<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>)

Federal Reserve (<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>)

TË TJERA

BIS Central Bank Research Hub (<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>)

International Journal of Central Banking (<http://www.ijcb.org/>)

National Bureau of Economic Research (<http://www.nber.org/>)

International Monetary Fund (<http://www.imf.org/external/pubind.htm>)

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.

Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569.

Faks: 355-4-2223558.

E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 500 kopje.